



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 11012 Prot

Lezhë, më 13 / 0 /2020

VENDIM

Nr. 105 datë 10 . 07 .2020

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR.46, DATË 13.11.2019 “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, LEHTËSIRAT FISKALE, STRUKTURAT E VJELJES SË TYRE DHE ATO TË VENDOSJES SE PENALITETEVE NDAJ KUNDRAVAJTËSVE”

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Urdhrin Nr.193, datë 20.03.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjes në Republikën e Shqipërisë”, në Urdhrin nr.193/1, datë 28.03.2020 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.193, datë 20.03.2020 Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë, në Urdhrin nr.208, datë 30.03.2020 “Për një ndryshim në urdhrin nr.193, datë 20.03.2020 Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjes në Republikën e Shqipërisë”, dalë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

V E N D O S I :

1. Të bëjë shtesat në pikën B.1, “Tarifa e Shërbimeve Publike”, në tabelën e nivelit të tarifave :
- a) Në pikën 1, “Njësi Tregtare”, shtohet germa “f”, me përmbajtjen “Tregtim materiale ndërtimi”, me nivelet treguese të tarifës si më poshtë :

Nr	Emërtimi	Njësia	Niveli i Tarifave	
			B.Sipas Xhiros vjetore, në milion lekë	
			0-8	Mbi 8
f.	Tregtim materiale ndërtimi	Lekë/vit	15.000	50.000

- b) Në pikën 2, “Njësi Prodhimi”, germa “c”, ishte me përmbajtjen “Prodhim & përpunim artikuj ushqimorë si bukë, bulmet, pije alkolike, vaji, ëmbëlsira, etj, të ngjashme me to”, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen “Prodhim & përpunim artikuj ushqimorë si bukë, bulmet, pije alkolike, vaji, ëmbëlsira, **produkte bujqësore** etj, të ngjashme me to”.
- c) Në pikën 3, “Njësi Ndërtimi”, shtohet germa “d”, me emërtimin “Investitor në Ndërtim”, me nivelet si më poshtë”.

Nr	Emërtimi	Njësia	Niveli i Tarifave	
			B.Sipas Xhiros vjetore, në milion lekë	
			0-8	Mbi 8
d.	Investitor në Ndërtim	Lekë/vit	10.000	20.000

d) Në pikën 4 “Njësi Shërbimi”, germa “b”, me përmbajtjen “Riparim artikuj elektroshtëpiake, Celularë, Radio, Tv, Frigoriferë, Lavatrice, Sobë, Biçikletë, Marangoz, Rrobaqepës, Këpucar, Orëndreqës, , etj të ngjashëm me to”, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen “Riparim artikuj elektroshtëpiake, Celularë, Radio, Tv, Frigoriferë, Lavatrice, Sobë, etj të ngjashëm me to”, ndërsa niveli i tarifës nuk ndryshon.

e) Në pikën 4 “Njësi Shërbimi”, shtohet germa “i”, me përmbajtjen si më poshtë :

Nr	Emërtimi	Njësia	Niveli i Tarifave	
			B.Sipas Xhiros vjetore, në milion lekë	
			0-8	Mbi 8
i	Riparim Biçiklete, Marangoz, Rrobaqepës, Këpucar, Orëndreqës, etj të ngjashëm me to.	Lekë/vit	10.000	20.000

2. Të bëjë shtesat në pikën B.6, “Tarifa për Shfrytëzim të ambjeteve të Institucioneve vartëse”, në tabelën e nivelit të tarifave, shtohet pika E, me përmbajtjen si më poshtë :

Nr	Kategoritë / Emërtimet e ambjeteve	Njësia	Niveli i Tarifës
E	Qendra Kulturore e Fëmijëve		
1	Salla e madhe e shfaqjeve	Lekë / Orë përdorimi	10.000
2	Salla e vogël		5.000

3. Të bëjë ndryshim të nivelit të tarifës, në pikën B.3 “Tarifa e Parkimit të Automjeteve”, pika 2, me emërtimin “Autoveturë / Taksi (8, 6, 4 + 1)”, e cila ishte me nivel 50 (pesëdhjetë) lekë/orë qëndrimi, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë :

Nr	Kategoria	Njësia	Niveli i Tarifës
			Vend parkim i miratuar me Pagesë (Vija Blu)
2	Autoveturë / Taksi (8, 6, 4+1)		
a	0 – 3 orë	Lekë /	100
b	3 – 8 orë	Orë	250
c	8 – 24 orë	Qëndrimi	300

4. Të bëjë zbritje në masën 20% të vlerës së përgjithshme të zërave të “Tarifave”, për kategoritë e taksapaguesve, që nuk kanë pasur të drejtë të ushtrojnë aktivitetin e tyre, referuar Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
ERNEST RAKAJ


